



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1347 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 198, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin paraprak të gërmimit arkeologjik të shpëtimit Korçë - Dersnik KM 46+595- KM 46+935, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin paraprak të gërmimit arkeologjik të shpëtimit Korçë - Dersnik KM 46+595- KM 46+935, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*"-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojë gërmimi arkeologjik në dy anët e kanalit edhe pas vendosjes së tubacionit, pikërisht në Lindje e Perëndim të zonave ku janë identifikuar gjurmë të ndërtimit të kasolleve, deri në përfundimin e të dhënave të mjaftueshme në dobi të vlerësimit të sitit, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k dhe ASHA.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e II (KM 0-69).
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al